

Në bazë të nenit 24, paragrafi (1), pika 1), nënpika 16 dhe nenit 149 të Ligjit të Energjetikës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 96/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19) dhe nenit 8 të Rregullores së Formulimit të Çmimeve më të Larta të Shitjes me Pakicë të Derivateve të Ndryshme të Naftës dhe të Lëndëve Djegëse të Transportit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 108/20 dhe 133/20), Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 14.09.2020, mori

V E N D I M

të përcaktimit të çmimeve më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit

Neni 1

(1) Çmimet më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse për transport janë:

- Benzinë për motorë - EUROSUPER BS – 95 - 58,50 (denarë/litër)
- Benzinë për motorë - EUROSUPER BS – 98 - 60,50 (denarë/litër)
- Naftë për motorë – EURODIZEL BS (D-E V) - 49,00 (denarë/litër)
- Vaj për djegie – Ekstra i Lehtë 1 (EL-1) - 49,00 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU - 24,549 (denarë/kilogram)

(2) Tregtarët me shumicë dhe tregtarët me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit, mund të formulojnë çmime të derivateve të ndryshme të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit edhe më të ulëta se çmimet më të larta të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni.

(3) Çmimet më të larta të shitjes me pakicë të formuluar në pajtueshmëri me paragrafin (1) të këtij neni, përveç çmimit të Mazutit M-1 SU, vlejnë për franko stacione të pompimit, ndërsa çmimi i Mazutit M-1 SU, vlen për deponime franko të tregtarit me shumicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit në vend.

(4) Te çmimet më të larta të shitjes me pakicë të formuluar në pajtueshmëri me këtë nen, përfshihet edhe tatimi i vlerës së shtuar në pajtueshmëri me Ligjin e Tatimit të Vlerës së Shtuar.

Neni 2

(1) Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë të derivateve të naftës dhe të lëndëve djegëse të transportit të përcaktuara në nenin 1 të këtij vendimi, janë të përfshira edhe çmimet më të larta të blerjes të cilat arrijnë vlera prej:

- Benzinë për motorë - EUROSUPER BS – 95	-	18,651 (denarë/litër)
- Benzinë për motorë - EUROSUPER BS – 98	-	20,311 (denarë/litër)
- Naftë për motorë – EURODIZEL BS (D-E V)	-	16,811 (denarë/litër)
- Vaj për djegie – Ekstra i Lehtë 1 (EL-1)	-	16,823 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	17,414 (denarë/kilogram)

Neni 3

Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë të përcaktuara në nenin 1 të këtij vendimi është i përfshirë edhe kompensimi i shpenzimeve të punës, nëpërmjet depos dhe marzhës tregtare, që për Eurosuperin BS-95 është 5,513 denarë/litër, për Eurosuperin BS-98 është 5,548 denarë/litër, për Eurodizelin BS (D-E V) është 5,513 denarë/litër, për Ekstra të Lehtë 1 (EL-1) është 5,491 denarë/litër, përderisa për Mazutin M-1 SU, kompensimi është 2,500 denarë/kilogram.

Neni 4

Çmimet më të larta të shitjes me pakicë të përcaktuara në nenin 1 të këtij vendimi, me përjashtim të Mazutit M-1 SU, përfshijnë edhe kompensimin e shpenzimeve të transportit nga depoja deri te pompat e benzinës në vlerë prej 0,75 denarë/litër për të gjitha derivatet e naftës.

Neni 5

Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë të përcaktuara në nenin 1 të këtij vendimi, përfshihet edhe kompensimi i financimit të aktiviteteve nga fusha e mjedisit jetësor, të cilin në pajtueshmëri me nenin 184, paragrafi 2, nënpika 2 e Ligjit të Mjedisit Jetësor, e paguajnë tatimpaguesit e përcaktuar me këtë ligj:

- Benzinë për motorë - EUROSUPER BS – 95	-	0,080 (denarë/litër)
- Benzinë për motorë - EUROSUPER BS – 98	-	0,080 (denarë/litër)
- Naftë për motorë – EURODIZEL BS (D-E V)	-	0,030 (denarë/litër)
- Vaj për djegie – Ekstra i Lehtë 1 (EL-1)	-	0,040 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	0,050 (denarë/kilogram)

Neni 6

Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë të përcaktuara në nenin 1 të këtij vendimi, përfshihet edhe kompensimi i rezervave të obligueshme të naftës dhe të derivateve të naftës, të cilin në pajtueshmëri me nenin 24, paragrafi (3) të Ligjit të Rezervave të Obligueshme të Naftës dhe të Derivateve të Naftës, e paguajnë tatimpaguesit gjatë importit dhe/ose prodhimit të derivateve të naftës:

- Benzinë për motorë - EUROSUPER BS – 95	-	0,890 (denarë/litër)
- Benzinë për motorë - EUROSUPER BS – 98	-	0,890 (denarë/litër)
- Naftë për motorë – EURODIZEL BS (D-E V)	-	0,300 (denarë/litër)
- Vaj për djegie – Ekstra i Lehtë 1 (EL-1)	-	0,300 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	0,740 (denarë/kilogram)

Neni 7

Në çmimet më të larta të shitjes me pakicë të përcaktuara në nenin 1 të këtij vendimi, akcizat që i paguajnë tatimpaguesit në pajtueshmëri me rregullat e akcizave, kanë këto vlera:

- Benzinë për motorë - EUROSUPER BS – 95	-	23,692 (denarë/litër)
- Benzinë për motorë - EUROSUPER BS – 98	-	23,692 (denarë/litër)
- Naftë për motorë – EURODIZEL BS (D-E V)	-	18,121 (denarë/litër)
- Vaj për djegie – Ekstra i Lehtë 1 (EL-1)	-	18,121 (denarë/litër)
- Mazut M-1 SU	-	0,100 (denarë/kilogram)

Neni 8

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e marrjes së tij, ndërsa do të fillojë të aplikohet nga ora 00:01 e datës 15.09.2020 dhe i njëjti do të botohet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe në faqen e internetit të Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ar sy e t i m

Me këtë vendim bëhet ulja e çmimeve të shitjes me pakicë të derivateve të naftës mesatarisht për 2,93 %, në raport me çmimet e shitjes me pakicë të derivateve të naftës, të përcaktuara në pajtueshmëri me vendimin e Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të datës 7.09.2020.

Çmimet referente të derivateve të naftës në tregun botëror në krahasim me periudhën e kaluar shtatëditore shënojnë ulje te benzina, mesatarisht për 5,950% ose për 24,150 \$/tonelatë, te nafta ka ulje mesatarisht për 9,999% apo për 34,300 \$/tonelatë, te vaji ekstra i lehtë ka ulje me një mesatare prej 9,239 % apo për 31,250 \$/tonelatë dhe te mazuti ka ulje mesatarisht për 9,018 % apo për 24,650 \$/tonelatë, për shkak se në strukturën e çmimeve të derivateve të naftës është kryer përshtatje adekuate.

Kursi i denarit, në raport me dollarin në periudhën e kaluar shtatëditore ka qenë 52,1851 den/\$ dhe është përafërsisht për 0,496 % më i lartë se kursi i dollarit (51,9276 den/\$), sipas të cilit janë formuluar çmimet e përlogaritjes së mëparshme.

Duke e pasur parasysh ndikimin e këtyre elementeve në formulimin e çmimeve të derivateve të naftës sipas metodologjisë, **çmimet e shitjes me pakicë të derivateve të naftës në pajtueshmëri me Metodologjinë e Formulimit të Çmimeve, ulen mesatarisht për 2,93%.**

Çmimet e shitjes me pakicë të benzinës EUROSUPER BS-95 dhe EUROSUPER BS-98 ulen për 1,00 denarë për litër, në raport me çmimet e përcaktuara me vendimin e datës 07.09.2020, kështu që çmimi i shitjes me pakicë i EUROSUPER BS-95 është 58,50 den/litër, ndërsa çmimi i shitjes me pakicë i EUROSUPER BS-98 është 60,50 denarë për litër.

Çmimi i shitjes me pakicë të EURODIZEL (D-E V) dhe i Vajit Ekstra të Lehtë të Amvisërisë (EL-1) ulen për 1,50 denarë/l, në raport me çmimet e përcaktuara me vendimin e datës 07.09.2020, kështu që çmimi i shitjes me pakicë të EURODIZEL (D-E V) është 49,00 denarë/l dhe çmimi i shitjes me pakicë i Vajit Ekstra të Lehtë të Amvisërisë (EL-1) është 49,00 denarë për litër.

Çmimi i shitjes me pakicë i Mazutit M-1 SU ulet për 1,407 denarë/kg në raport me çmimin e përcaktuar me vendimin e datës 07.09.2020, kështu që çmimi i shitjes me pakicë i Mazutit M-1 SU është 24,549 denarë/kg.

Akizatat e derivateve të naftës në të gjitha grupet e çmimeve të shitjes me pakicë janë përcaktuar në pajtueshmëri rregullat e akcizave. Çmimet e shitjes me pakicë të përcaktuara me këtë vendim përmbajnë: kompensimin e financimit të aktiviteteve në fushën e mjedisit jetësor, që në pajtueshmëri me Ligjin e Mjedisit Jetësor, e paguajnë tatimpaguesit e përcaktuar me këtë ligj dhe kompensimin e rezervave të obligueshme të naftës dhe derivateve të naftës, që në pajtueshmëri me Ligjin e Rezervave të Obligueshme të Naftës dhe të Derivateve të Naftës, e paguajnë tatimpaguesit e përcaktuar me këtë ligj gjatë importit dhe/ose prodhimit të derivateve të naftës.

Nr. 02-1869/1

14.09.2020

S h k u p

**Kryetar i Komisionit Rregullator të
Energjetikës dhe të Shërbimeve të
Ujit të Republikës së Maqedonisë
së Veriut**

Марко Бислимоски